



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15826/21 datë:05.07.2021



Npi – 01/202 Datë: 14.07.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe nenin 40.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 5 të Ligjit për Buxhetin e Rishikuar Nr.07/L-14; Udhëzimi Administrativ 06/2019 për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale, si dhe mbi bazën e prezentimit nga Zyra Komunale për Financa të Propozim-Vendimit për destinimin e rezervës buxhetore, në emërtimin e projekteve të reja kapitale, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 14.07.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E DESTINIMIT TË REZERVËS BUXHETORE NË EMËRTIMIN E PROJEKTEVE TË REJA KAPITALE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 14.07.2021 me shumicën e votave aprovoi, vendimin për destinimin e Rezervës Buxhetore Komunale, në riemërtimin e projekteve kapitale, sipas tabelës në vijim:


Nr.	Emërtimi i Projektit	Burimi i Financimit	Planifikimi	Parashikimi	Parashikimi
			2021	2022	2023
1	Rregullimi i shtigjeve për çiklizëm në fshatin Mollopolc	21-THV	12,000	10,000	-
Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik – Totali:			12,000	10,000	-
2	Rregullimi i shtratit të Lumit Shtimjanja	10-GQ	15,000	30,000	240,051
3	Rregullimi i rrugëve dhe rrjetit të kanalizimit në Shtime	10-GQ	20,810	20,000	-
4	Rregullimi dhe zgjerimi i Urave në fshatrat Rashincë dhe Carralevë	10-GQ	-	20,000	70,000
Planifikim Urban – Totali:			35,810	70,000	310,051
5	Rregullimi i ndriçimit publik në të gjitha fushat sportive të Komunës	10-GQ	18,000	58,000	-
Kultura dhe Sporti – Totali:			18,000	58,000	-
Buxheti i Planifikuar – Totali:			65,810	138,000	310,051

II

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj